



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

ZËVENDËSKRYETARE

Ermonela Felaj (Valikaj)

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN
E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

Duke njohur përpjekjet e Komisionerit drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë për detyrë realizimin e reformës në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2021 në drejtim të:

Përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga Kuvendi në rezolutën e datës 3.6.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2021”.

Koordinimit dhe kontrollit të veprimeve administrative të realizuara gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në shërbimin civil të nëpunësve gjyqfitues, konsolidimit të bazës së të dhënave, vijimit të procesit lidhur me konsolidimin e databazës dhe zgjidhjes së problemeve që dalin gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues.

Mbikëqyrjes së procesit të lirimit nga shërbimi civil të punonjësve që kanë plotësuar moshën për të dalë në pension të plotë pleqërie, evidentimit të 219 rasteve.

Rritjes së transparencës në drejtim të njohjes së publikut me veprimtarinë e Komisionerit.

Realizimit të procesit të vlerësimit të impaktit të ligjit për nëpunësin civil që nga momenti i miratimit të tij duke kërkuar mendim edhe nga vetë nëpunësit civilë, për vlerësimin që ata

kanë ndaj ligjit dhe për garancitë që i jep ligji gjatë kryerjes së detyrës. Gjithashtu, nëpërmjet këtij procesi u evidentuan edhe problemet që konstatohen gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji.

Ngritjen e një grupi të posaçëm për t'i ardhur në ndihmë administrimit të shërbimit civil në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me asistencë në kohë reale për çdo nevojë.

Trajtimin të të gjitha informacioneve për 145 kërkesa/ankesa, që kanë ardhur për shqyrtim në drejtim të Komisionerit.

Përfshirjes në procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme dhe tematike të 13 subjekteve me tipologji të ndryshme të institucioneve në shërbimin civil, të planifikuara për t'u kontrolluar në planin vjetor.

Procesin të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të zhvilluara më 25 prill 2022.

Mbikëqyrjes “online” në kohë reale për rekrutimet, për 700 pozicione pune pranë DAP-it, duke monitoruar procedurat e konkurrimit për rekrutimin në grup, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë në administratën shtetërore për 487 pozicione pune, si edhe zbatimin e listës së fituesve të konkurrenive të mëparshme, listës së pritjes për shkak të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe të emërimeve nga transferimet e përhershme në përfundim të pezullimit për 113 raste, me qëllim që të parandalohen shkeljet ligjore në pikëpamjen procedurale, të sigurohet një proces i drejtë dhe transparent konkurrimi.

Verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit pas përfundimit të afatit të paralajmërimit si për subjektet e mbikëqyrura, ashtu edhe për inspektimet individuale të lidhura me trajtimin e ankesave të nëpunësve civilë.

Studimit të impaktit pozitiv në rritjen e performancës së institucioneve, të cilat kanë përfshirë ekselencën në shërbimin civil.

Kuvendi kërkon që Komisioneri për vitin 2022 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të adresojë pranë Kuvendit nëpërmjet mekanizmave ligjorë propozimet për ndryshimet e ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore, me qëllim zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë zbatimit të tij.

2. Të monitorojë dhe të luajë rol aktiv në skemën e administrimit të shërbimit civil në administratën vendore, konkretisht në ndërtimin e strukturës, përcaktimin e saktë të numrit të nëpunësve civilë, qartësimin e pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil.

3. Të nxisë dhe të monitorojë popullimin me të dhëna të platformës së bashkëpunimit “administrata.al” nga të gjitha subjektet e shërbimit civil, si dhe të angazhohet në hartimin e bazës ligjore dhe funksionimin e platformës “administrata.al”.

4. Të mbikëqyrë institucionet e administratës shtetërore për përgatitjen e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil.

5. Të rrisë transparencën në drejtim të njohjes së publikut me veprimtarinë e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil nëpërmjet publikimeve më të shpeshta në faqen zyrtare.

6. Të krijojë një hapësirë të dedikuar në faqe për seksionin pyetje-përgjigje për palët e interesuara, institucione publike apo individë në lidhje me interpretimin e dispozitave të ligjit.

7. Të angazhohet në ofrimin e trajnimeve periodike për nëpunësit civilë të njëjësive përgjegjëse në të gjitha institucionet e administratës publike, sidomos në bashkitë me një numër të kufizuar të banorëve, veçanërisht në institutet e ligjit ku hasen problematika.

8. Në bashkëpunim me institucionet e vetëqeverisjes vendore që punësojnë nëpunës civilë, të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore për 6 bashkitë që u përfshinë në procesin e zgjedhjeve të pjesshme vendore në vitin 2022. Për të gjitha proceset zgjedhore në të ardhmen të hartohen plane pune monitorimi dhe të paraqiten raporte analitike për përmbushjen e detyrimeve të nëpunësve civilë dhe

institucioneve që punësojnë nëpunës civilë gjatë periudhës zgjedhore në zbatim të udhëzimeve të Komisionerit.

9. Të zgjerojë planin e mbikëqyrjes me institucionet e pavarura, me qëllim që të mundësojë një proces vlerësimi të situatës së zbatimit të dispozitave të ligjit për nëpunësin civil në këtë tipologji institucionesh.

10. Të luajë rol aktiv në mbikëqyrjen e procedurave të rekrutimit për pozicionet e punës që kërkojnë një edukim arsimor në fushën e drejtësisë, duke marrë pjesë me stafin e institucionit gjatë intervistave të strukturuar me gojë dhe njëkohësisht të bashkëpunojë me Shkollën e Administratës Publike, për të ofruar trajnime specifike për të gjithë nëpunësit civilë që kanë një profil arsimor në këtë fushë.

Miratuar në datën 30.5.2022